



Udhëzues informativ ligjor

E drejta për informim në Shqipëri

Mbështetur nga:



Shkoder, Shtator 2016

Udhëzues informativ ligjor

E drejta për informim në Shqipëri

Ky manual prezanton në mënyrë të përmbledhur kornizën ligjore se ku mbështetet e drejta për informim në Shqipëri. Synimi është që punonjësit e administratës publike, përfaqësuesit e OJF-ve qytetarët dhe të gjithë aktorët e interesuar të orientohen nga ana ligjore se ku mbështetet e drejta e tyre për informim. Autori nëpërmjet komenteve ka prezantuar edhe ato dobësi apo boshllëqe në legjislacion të cilat janë identifikuar. Nëpërmjet këtij botimi bëhet e mundur njohja më e mirë e legjislacionit duke e bërë më të lehtë zbatimin e tij dhe duke kontribuar në një ushtrim efektiv të së drejtës për informim.

Ky publikim u përgatit nga Dr.Blendi Dibra, ekspert i të Drejtës Publike dhe aktivist i shoqërisë civile, me iniciativën e shoqatës “Intelektualët e rinj, Shpresë”, në kuadër të projektit “Informohu, Dialogo, Reago!”, dhe është mundësuar me mbështetjen financiare të Agjensisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit, opinioni i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i Agjensisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

© Shoqata “Intelektualet e rinj, Shprese”

Riprodhimi është i autorizuar, vetëm për qëllime publikimi, me kusht identifikimin e autorit.

Pasqyra e Lendes:

1.Informimi si një e drejtë themelore e qytetarëve	3
2.Informimi dhe pjesmarrja në vendimmarrje	6
3.Aktet Ndërkombëtare për të drejtën e informimit ku aderon Shqipëria	7
3.1 Deklarata e Universale e të Drejtave të Njeriut	8
3.2 Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike	10
3.3 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore	11
3.4 Konventa mbi të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit	13
3.5 Konventa për Pjesmarrjen e të Huajve në Jetën Publike, në Nivel Lokal	16
4.Legjislacioni shqiptar mbi të drejtën e informimit	17
4.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë	17
4.2 Ligji për Vetëqeverisjen Vendore	20
4.3 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë	24
4.4 Ligji “Për të drejtën e informimit”	25
4.5 Ligji “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”	30
5.Perfundime	34
6.Rekomandime	38
7.Lexime te metejshme	40



1. Informimi si një e drejtë themelore e qytetarëve



E drejta e informimit përbën një të drejtë themelore, e cila sanksionohet në shumë akte dhe dokumenta ndërkombëtare. Shoqëria demokratike është e lidhur ngushtë me respektimin e

të drejtave themelore të njeriut ku *“Demokracia dhe liria e shprehjes kanë bashkëjetuar gjatë dhe nuk mund të ekzistojnë të ndara”*¹

Informimi redukton distancën që ekziston ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë. Shkëmbimi i informacionit e bën qeverisjen e hapur, transparente dhe të përgjegjshme, duke i krijuar më tepër mundësi qytetarëve të ushtrojnë të drejtat e tyre. Në këtë mënyrë, shoqëritë demokratike nuk mund të konceptohen vetëm me një sistem qeverisës i cili krijohet nga zgjedhjet e lira, por me një sistem ku publiku mund të marrë pjesë në qeverisje jo vetëm në ditën e zgjedhjeve, por në mënyrë të vazhdueshme. Qytetarët duhet të informohen mbi aktivitetin e qeverisë, të lejohen të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes, të kenë të drejtë t'i drejtohen gjykatës në funksion të mbrojtjes së të drejtave të tyre, mirëqenies sociale dhe promovimit të zhvillimit të shoqërisë. Duke pranuar gjithashtu se publiku ka nevojë të ndërgjegjësohet për procedurat e pjesëmarrjes në vendimmarrje, si të ushtrojë lirisht të drejtën e pjesëmarrjes dhe si të ushtrojë të drejtat e njohura nga ligji, garantimi i të drejtës për informim thëllon përgjegjësinë dhe transparencën e qeverisjes duke rritur besimin e publikut ndaj saj.

¹ Guidi, G. *“La società dell' informazione: libertà, pluralismo, risorse”*, Diritto Pubblico Comparato ed Europeo, Atti del convegno dell'Associazione di San Marino, 30 Settembre 2005, G. Giappichelli Editore, 2006, fq 2.



Informacioni është hapi i parë i edukimit të publikut në një demokraci. Duke marrë të gjithë informacionin e duhur, publiku ndërgjegjësohet dhe aftësohet për të marrë pjesë në vendimet që ndikojnë për jetën e tyre. Përmirësimi i të drejtës për informim nxit pjesëmarrjen publike në vendimmarrje, nxit përmirësimin e cilësisë dhe zbatimin e vendimeve, kontribuon në ndërgjegjësimin e publikut. Në këtë mënyrë, qytetarët kanë më tepër mundësi për të shprehur shqetësimet dhe për t'i imponuar alternativat e tyre autoriteteve publike. Liria e shprehjes dhe e drejta e informimit janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Ato janë jetike për një shoqëri demokratike dhe përbëjnë thelbin e zhvillimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Shpesh e drejta për informim është kufizuar në mënyrë abuzuese nga qeveritë me justifikimin e mbrojtjes së sigurisë kombëtare, por mekanizma dhe instrumenta ligjor janë ndërtuar për t'i reduktuar këto kufizime të cilat duhet të bëhen vetëm sipas disa parimeve kryesore. Në çdo rast kufizimet nuk duhet të çënojnë të drejtën e informimit. Sipas indeksit 2015 *“Për lirinë e shtypit”*, të Freedom House rezulton se:

“...vetëm 14% e qytetarëve të botës jetojnë në vende që gëzojnë lirinë e shtypit. Në pjesën tjetër të botës, qeveritë dhe aktorët jo shtetërorë kontrollojnë këndvështrimin e qytetarëve dhe shtypin brutalisht zërat e pavarur që synojnë të promovojnë llogaridhënjen, qeverisjen e mirë dhe zhvillimin ekonomik”²

Duke patur parasysh se është e domosdoshme që njerëzit të monitorojnë sjelljen e qeverisë së tyre dhe të marrin pjesë plotësisht në qeverisjen e një shoqërie demokratike, është themelore që ata të kenë akses dhe të informohen në lidhje me aktivitetin qeverisës. Prandaj e drejta për informim është një e drejtë e cila zë një vend të rëndësishëm në të drejtën ndërkombëtare. Garantimi në ushtrimin e kësaj të drejte e cila shoqërohet nga një praktikë gjyqësore e zhvilluar në mbrojtjen dhe interpretimin e saj, përbën një kolonë

² Shih: <https://freedomhouse.org/report-types/freedom-press>



të rëndësishme për ndërtimin e shoqërive demokratike kudo në botë. Aktet ndërkombëtare nuk kanë parashikuar limite dhe kufij në përdorimin e mënyrave dhe formave të komunikimit. Prandaj jo vetëm përdorimi i mediave apo mjeteve elektronike është i rëndësishëm, por edhe i formave apo mënyrave të tjera të komunikimit. E drejta për informim është një proces shkëmbimi i dyanshëm ku qeverisja dhe publiku komunikojnë në mënyrë të ndërsjelltë. Duke pranuar rëndësinë e integritit të plotë të opinionëve dhe sygjërimeve të publikut në vendimmarrje dhe nevojën që kanë autoritetet publike për të poseduar informacion të saktë, të gjithanshëm nga grupe dhe shtresa të ndryshme është domosdoshmëri ndërtimi i mekanizmave efektiv ligjor.

Pra, pjesmarrja publikut në qeverisje lidhet ngushtë me të drejtën për t'u informuar. Informacioni përbën kushtin thelbësor për një pjesmarrje efektive të publikut në qeverisje. Duke qenë se informimi përbën një të drejtë të patjetërsueshme e cila nxit transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë, kjo e drejtë është sanksionuar nga akte dhe dokumenta të ndryshëm ndërkombëtar. Shqipëria ka aderuar dhe ka përfshirë të drejtat dhe detyrimet që lindin nga zbatimi i këtyre akteve në të drejtën e saj të brendshme³. Zbatimi i këtyre akteve ndërkombëtare dhe legjisllacionit përkatës sigurisht që ndikojnë në rritjen e pjesmarrjes dhe angazhimit qytetar në vendin tonë në të gjitha nivelet e qeverisjes.

³ Omari, Luan, 2007, *"Parime dhe Institucione të së Drejtës Publike"*, Tiranë: Elena Gjika, fq 6



2 Informimi dhe pjesmarrja në vendimmarrje

Për një qeverisje të mirë dhe demokratike, respektimi i të drejtës për informim përbën një nga elementët thelbësorë që duhet të garantohet për të gjithë qytetarët. Respektimi i kësaj të drejte duke e ofruar atë në kohë dhe në mënyrë të plotë për qytetarët, luan një rol kyç për të nxitur pjesmarrjen e qytetarëve në qeverisje dhe në përmirësimin e vendimmarrjes. Vetëm një qeverisje që respekton parimin e transparencës gjatë aktivitetit të saj është e ndërgjegjshme për respektimin e të drejtës së informimit që kanë qytetarët. Në këtë mënyrë zhvillohet një proces edukimi dhe ndërgjegjësimi për qeverisjen, ku ndikon për një përfshirje më të gjerë të qytetarëve dhe ndarje të përgjegjësive qeverisëse. Prandaj legjislacioni europian⁴ dhe Ombudsmani Europian kanë krijuar konceptin se:

*"mirëqeverisja lidhet më shumë me marrëdhëniet mes individëve dhe administrates publike, në të cilën s' kemi thjesht në vëmendje vlerat e qytetarisë dhe institucionet e qeverisjes, por sjelljen në vëmendjen e interesave individuale të veprimtarisë së administratës komunitare"*⁵

Për të krijuar kushtet për respektimin e të drejtës së informimit sigurisht që është kusht i domosdoshëm që kuadri ligjor të jetë i ndërtuar mbi parimin e transparencës dhe në respektimin e të drejtës së informimit. Prandaj e drejta informimit përbën një element kryesor për nxitjen e pjesmarrjes së tyre në qeverisje.

Qytetarët ushtrojnë të drejtën e tyre të qeverisjes në nivel lokal. Duke qenë se është një detyrim ligjor, pushteti vendor në Shqipëri duhet të jetë sa më transparent dhe të informojë publikun në lidhje me veprimtarinë e organeve vendimmarrëse. Pra që në hapat e para të krijimit të qeverisjes lokale dhe deri në përfundim të mandatit të saj, shkëmbimi i informacionit

⁴ Shih: neni 41 dhe 45 i TBE-së

⁵ Shih: Merloni, F. 2008 "*La trasparenza amministrativa*", Milano: Giuffrè Editore, fq. 237



përbën urën e parë e cila shkurton distancën ndërmjet organeve qeverisëse dhe të qeverisurve. Kjo marëdhënie sigurisht që duhet të ndërtohet në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin përkatës mbi të drejtën e informimit, ku përcaktohen edhe kufijtë e kësaj të drejte. Një nga mjetet më të rëndësishme në realizimin e kësaj të drejte është krijimi i një legjislacioni të mirë dhe zbatimi efektiv i tij në praktikë. Për të krijuar një ide më të mirë mbi kuadrin ligjor se ku mbështetet kjo e drejtë, më poshtë po prezantojmë një vështrim analitik të akteve ligjore ndërkombëtare ku Shqipëria ka aderuar, si dhe të legjislacionit shqiptar mbi të drejtën e informimit. Ky prezantim i përgatitur në mënyrë të përgjithshme dhe analitike do të na ndihmoj për të kuptuar më mirë rëndësinë që ka e drejta e informimit, e cila është sanksionuar jo vetëm si një e drejtë kushtetuese por edhe si një pjesë e rëndësishme e të drejtës ndërkombëtare. Duke qenë e tillë, ajo përbën një nga te drejtat kryesore për pjesmarrjen e qytetarëve në qeverisje nga njëra anë dhe nga ana tjetër krijon kushtet për një qeverisje të hapur dhe transparente.

3 Aktet Ndërkombëtare për të drejtën e informimit ku aderon Shqipëria.

Shqipëria ka aderuar në një sërë aktesh dhe dokumentash, të cilat garantojnë të drejtën për informim si një e drejtë themelore e njeriut. Kjo e drejtë përbën edhe një ndër elementet kryesore për pjesmarrjen e qytetarëve në qeverisje. Ndër aktet kryesore të cilat sanksionojnë të drejtën për informim dhe ku Shqipëria bën pjesë mund t'i rendisim si më poshtë:



3.1 Deklarata e Universale e të Drejtave të Njeriut⁶



E drejta themelore për akses të informacionit publik garantohet nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Deklarata përbën një nga dokumentat

themelore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Shqipëria ka aderuar në vitin 1955⁷ duke u angazhuar në përbushjen e detyrimeve të saj dhe duke e bërë deklaratën pjesë të së drejtës së brendshme. Në tekstin e kësaj deklarate dhe pikërisht në nenin 19 përcaktohet qartë se gjithkush ka lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë⁸.

Pra ky akt ndërkombëtar i ka dhënë të drejtës për informim një kuptim të dyanshëm ku përveç marrjes, i njej publikut të drejtën edhe të dhënies së informacionit me çfarëdo lloj mjeti, duke mos njohur kufij në ushtrimin e kësaj të drejte. Megjithatë, Konventa pranon mundësinë e kufizimeve vetëm kur parashikohen me ligj dhe kanë si qëllim të sigurojnë njohjen dhe respektimin e nevojshëm të të drejtave dhe të lirive të të tjerëve, kujdesin ndaj rregullave të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në shoqërinë demokratike⁹.

Të frymëzuar nga neni 19 i kësaj deklarate, një grup ekspertësh të së drejtës ndërkombëtare, sigurisë kombëtare, dhe të drejtave të njeriut, të mbështetur nga Qendra Ndërkombëtare ndaj censurës në bashkëpunim me

⁶ Deklarata e Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR) u shpall më 10 Dhjetor të vitit 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

⁷ Shih: neni 5, VKM nr.870, datë 3.11.2010,

⁸ Shih: neni 19, Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut,

⁹ Shih: Po aty, neni 29



Qendrën për Studime Ligjore të Aplikuara dhe Universiteti i Witwatersrand, në Johannesburg, më 1 Tetor 1995, miratuan një dokument, të ashtuajturin: *“Parimet e Johannesburgut mbi sigurinë kombëtare, lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informimit”*¹⁰. Këto parime bazohen në të drejtën ndërkombëtare dhe rajonale, që lidhet me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, zhvillimin e praktikave ligjore që reflektohen në gjykimet e gjykatave kombëtare, si dhe parimet e përgjithshme të së drejtës, të njohura nga shtetet anetare. Këto parime të cilat gjejnë zbatim edhe në legjislacionin shqiptar, në mënyrë të përmbledhur përfshijnë:

1. Institucionet publike duhet të jenë të detyruara të publikojnë informacionin kryesor;

- a) mbledhjet e tyre duhet të jenë të hapura për publikun;*
- b) këto institucione duhet të promovojnë qeverisjen e hapur;*
- c) legjislacioni i së drejtës për informim duhet t'i shërbejë transparencës maksimale.*

2. Kërkesave për informim duhet t'u jepet përgjigje me shpejtësi e saktësi dhe në raste të veçanta mund të ketë edhe refuzime, përjashtimet duhet të jenë paraqitur qartësisht dhe hollësisht.

3. Individët nuk duhet të frenohen nga autoriteti publik për të paraqitur kërkesat e tyre për informim nëpërmjet kostos administrative.

4. Ligjet që bien në kundërshtim me principin e hapjes maksimale të qeverisë duhet të amendohen apo ribëhen.

¹⁰ Article 19.1996. "The Johannesburg Principles on National Security, Freedom of Expression and Access to Information", London: Article 19, fq 4



3.2 Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike¹¹



Një tjetër akt i rëndësishëm ndërkombëtar është Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike¹² i cili garanton të drejtën e informimit për të gjithë qytetarët. Ky akt shprehet pothuajse në mënyrë të njëjtë me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, por përcakton në mënyrë më të detajuar mënyrën dhe formën e ushtrimit të kësaj të drejte. Thelbi i këtij akti në lidhje me të drejtën e informimit shprehet në nenin 19, pika 2 ku thuhet se:

“Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, goftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij.”

Pra, ky dokument nuk ka kufizuar subjektet të cilat kanë të drejtën e kërkimit, të marrjes dhe të përhapjes së informacionit. Po ashtu nga përkufizimi i mësipërm rezultojnë se mënyrat e dhënies dhe të marrjes së informacionit nuk duhet të jenë të kufizuara. Mjetet e informimit duhet të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë për të bërë të mundur ushtrimin efektiv të së drejtës së informimit.

¹¹ **Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike** (ICCPR) është një traktat shumëpalësh i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më **16 Dhjetor 1966** dhe hyri në fuqi me date 23 Mars 1976. Pakti detyron palët e saj për respektimin e të drejtave civile dhe politike të individëve, duke përfshirë të drejtën për jetën, lirinë e fesë, lirinë e fjalës, lirinë e tubimit, të drejtat zgjedhore dhe të drejtat për një proces të rregullt dhe një gjykim të drejtë

¹² **Shqipëria** ka aderuar në ICCPR, me ligjin nr.7510, më date 8.8.1991.



3.3 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore¹³



Një akt mjaft i rëndësishëm ndërkombëtar i cili sanksion të drejtën e informimit është edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive

Themelore¹⁴. Teksti i Konventës interpretohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), vendimet e se cilës përbëjnë precedentë të detyrueshëm duke u kthyer në norma ligjore detyruese. Kështu me ratifikimin e Konventës, autoritetet kombëtare të të gjitha shteteve nënshkruese, duke përfshirë ato që praktikojnë një sistem ligjor civil (kontinental), janë të detyruara t'i konsiderojnë vendimet e Gjykatës si ligje të detyrueshme¹⁵.

Liria e shprehjes si një e drejtë themelore e parashikuar nga konventa, përfshin si një element thelbësor të drejtën për t'u informuar. Liria e shprehjes pa u informuar sigurisht nuk do të kishte kuptim, duke qenë se forca e argumentit e bazuar mbi fakte ligjore do të ishte e turbullt. Prandaj konventa lirinë e shprehjes e ka parashikuar si shumë përmbledhëse të lirisë së mendimit dhe lirisë për të marrë ose dhënë informacion¹⁶. Në këtë kontekst, Konventa njeh lirinë për të marrë informacion pa pasur ndërhyrje nga autoritetet publike si një të drejtë themelore të njeriut, të cilën shtetet palë të Konventës duhet ta respektojnë.

¹³ **Konventa Evropiane Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ECHR)** e cila u nënshkrua më **4 Nëntorë 1950** në Romë, Itali dhe hyri në fuqi më **3 Shtator 1953**, është një marrëveshje ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Europë.

¹⁴ **Shqipëria** ka aderuar në ECHR, me ligjin nr.**8137**, datë **31.7.1996**.

¹⁵ Monika Carss-Frisk.2003 "**Liria e shprehjes**", Manuallet e të drejtave të njeriut Nr 2, Një udhëzues për zbatimin e nenit 10 të KEDNJ, Botimi i dytë, Tiranë: Gent Grafik, fq. 5

¹⁶ Shih: pika 1, neni 10, **Konventa Evropiane Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore**,



Liria për të marrë informacion, përfshin të drejtën për të mbledhur informacion dhe për të kërkuar informacion nëpërmjet të gjitha burimeve të mundshme ligjore. Liria për të marrë informacion mbulon gjithashtu edhe transmetimet audio vizive ndërkombëtare. Kjo liri lidhet me median me qëllim që të mundësojë këtë të fundit t'i shpërndajë publikut informacione dhe opinione të ndryshme. GJEDNJ e ka interpretuar këtë të drejtë si të drejtën e publikut për t'u informuar në mënyrën e duhur, në veçanti për çështjet e interesit publik¹⁷. Ajo ka marrë vendime të rëndësishme që përbëjnë interpretime të detyrimeve të Konventës. Gjykatat e të gjitha shteteve palë të Konventës duhet të aplikojnë sa herë të ketë raste të ngjashme vendimet dhe interpretimet e GJEDNJ-së.

Hapsira e ofruar nga konventa për t'i dhënë mundësi qytetarëve për të ushtruar të drejtën e informimit sigurisht që nuk duhet të keqpërdoret.

Ushtrimi i këtyre të drejtave është përgjegjësi dhe çdokush është i detyruar t'i respektoj në mënyrën e duhur. Ato duhet të ushtrohen deri në limitet e përcaktuara nga konventa. Në çdo rast kufizimi i tyre duhet të jetë i përcaktuar me ligj brenda normave të së drejtës që konventa ka vendosur¹⁸. Pra si përfundim, rezulton se Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut përveç garantimit të plotë të lirisë së shprehjes, si një e drejtë themelore e njeriut, në të njëjtën kohë përpiket edhe të mbrojtë dinjitetin njerëzor kundër shpifjes apo shkeljeve të tjera të ngjashme.

¹⁷ Monika Carss-Frisk.2003 "*Liria e shprehjes*", Manuallet e të drejtave të njeriut Nr 2, Një udhëzues për zbatimin e nenit 10 të KEDNJ, Botimi i dytë, Tiranë: Gent Grafik, fq. 13

¹⁸ Shih: pika 2, neni 10, pika 2, *Konventa Evropiane Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore*



3.4 Konventa mbi të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit¹⁹ (UNECE)

Kjo konvente, e njohur ndryshe si Konventa e Aarhusit²⁰, është një ndër aktet më të rëndësishme



ndërkombëtare që sanksionon në mënyrë mjaft të qartë dhe të drejtpërdrejtë të drejtën e publikut për të pasur informacion. Por konventa nuk kufizohet vetëm tek e drejta e informacionit. Ajo i jep hapsirë më të madhe pjesmarrjes së publikut në një kuptim më të plotë. Në këtë konventë në ndryshim me aktet e tjera ndërkombëtare, përfshihet jo vetëm e drejta e publikut për të pasur informacion por edhe e drejta për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit. Konventa fokusohet tek çështjet e mjedisit duke patur një objektiv më specifik dhe të përcaktuar qartë. Qëllimi i kësaj konvente është mbrojtja e të drejtës kolektive dhe interesit të çdo individi për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij. Për realizimin e këtij objekti, ajo detyron çdo palë që aderohet në konventë të garantojë të drejtën e publikut për të patur informacion, për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes, si dhe t'i drejtohet gjykatës në lidhje me çështje të mjedisit, në përputhje me klauzolat e konventës. Për të përcaktuar qartë subjektet të cilat konventa i ngarkon me detyrimin për zbatimin e saj, **“autoriteti publik”** përfaqëson në një kuptim të zgjeruar qeverisjen në të gjitha nivelet e saj duke përfshirë edhe subjekte të tilla si persona fizikë apo juridikë, të cilët kryejnë shërbime apo funksione publike

¹⁹ *Konventa mbi të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, (UNECE), u nënshkrua më 25 Qershor 1998 në qytetin danez të Aarhusit dhe hyri në fuqi më 30 Tetor 2001*

²⁰ Shqipëria ka aderuar në UNECE, me ligjin nr. 8672, datë 26.10 2000



administrative sipas ligjit kombëtar. Po ashtu janë përfshirë edhe institucionet e çdo organizate rajonale të integritit ekonomik të cilat janë palë në këtë Konventë²¹. Por sipas këtij përkufizimi nuk janë përfshirë organet ose institucionet që veprojnë si kapacitet gjykues ose legjislativ. Konventa, në pikën 3, të nenit 2, duke përkufizuar si "*informacionin mjedisor*" format e komunikimit, ka përfshirë informacionin e dhënë me shkrim, në mënyrë vizuale, gojore, elektronike ose çdo lloj forme tjetër. Ndërsa përkufizimin e "*publikut*" të cilin e jep në pikën 4 dhe 5, të nenit 2, e ka ndarë në dy lloje:

1. "*Publiku*" ku nënkuptohen një ose shumë persona fizikë ose juridikë, në përputhje me legjislacionin e praktikat kombëtare, shoqatat, organizatat dhe grupimet e tyre;

2. "*Publiku i interesuar*" ku nënkuptohet publiku i ndikuar ose që mund të ndikohet, apo që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore. Sipas qëllimit të këtij përkufizimi, shoqatat joqeveritare që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe plotësojnë kërkesat e vëna në ligjet kombëtare, do të konsiderohen si palë të interesuara.

Konventa në nenin 3 të saj kërkon që të merren të gjitha masat e nevojshme legjislative dhe çdo masë tjetër e nevojshme për zbatimin e kushteve të së drejtës së informimit, duke kërkuar që autoritetet dhe zyrtarët të ndihmojnë dhe të asistojnë publikun në momentin kur kërkon që të informohet për mjedisin. Ato duhet të promovojnë edukimin mjedisor dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, veçanërisht për të kërkuar informacion rreth mjedisit, për të marr pjesë në vendimmarrje dhe për të ushtruar të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës. Synimi i Konventës është që të zgjerojë të drejtën e publikut për të pasur informacion për mjedisin përtej asaj që është parashikuar

²¹ Shih: pika 2, neni 2, UNECE



në konventë. Një kusht i tillë përbën detyrim për ato shtete të cilat e kanë ratifikuar konventën. Në nenin 4, të Konventës thuhet se:

“...autoritetet publike, në përgjigje të kërkesës për informacion mjedisor, ta bëjnë informacionin të disponueshëm, brenda kuadrit të ligjit kombëtar...”

Pra, konventa duke përcaktuar modalitetet e duhura, kërkon nga autoritetet publike që të bëjnë të disponueshëm të gjithë informacionin e nevojshëm duke i detyruar ato të jenë sa më transparente. Për këtë qëllim dhe në mënyrë që e drejta për informim të ushtrohet në mënyrë efektive, konventa kërkon që të vendosen edhe afate kohore brenda së cilave duhet të jepet ky informacion për publikun. Sigurisht që në raste të caktuara dhe specifike është parashikuar edhe mundësia e kufizimit të informacionit por gjithmonë pa cënuar thelbin e asaj që përbën të drejtën e informimit për publikun. Në funksion të mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit mjedisor, konventa kërkon që të krijohen sisteme detyruese të cilat sigurojnë transmetim të përshtatshëm të informacionit për mjedisin²². Synimi është që të sigurohen mekanizmat për realizimin e produkteve të mjaftueshme informative, në mënyrë që duke u bërë të disponueshme për publikun, të aftësojnë konsumatorët me të gjithë informacionet e nevojshme për mjedisin në mënyrë që ato të bëjnë zgjedhjet e duhura. Konventa ka përcaktuar gjithashtu procesin dhe kushtet e nevojshme mbi bazën e të cilave një informacion bëhet i disponueshëm²³

²² Shih: neni 5, UNECE,

²³ Shih: neni 5, UNECE



3.5 Konventa për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike, në Nivel Lokal²⁴

Shqipëria ka ratifikuar me ligjin Nr.9364, datë 31.3.2005, një tjetër akt të rëndësishëm ndërkombëtar *Konventën për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike, në Nivel Lokal*. Nëpërmjet kësaj konvente sanksionohet e drejta e një spektri më të gjerë të publikut, duke ofruar garanci ligjore për ato të cilët nuk janë shtetas të një shteti por të cilët janë ligjërisht banorë të territorit të atij vendi. Siç kemi theksuar, një nga kushtet themelore për pjesëmarrjen në jetën publike është garantimi i të drejtës për informim, prandaj edhe nëpërmjet këtij akti konstatohet rëndësia që ka kjo e drejtë duke u kërkuar sanksionimi i saj nëpërmjet instrumentave ligjor. Sigurimi i informacionit në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e banorëve të huaj përbën një nga detyrimet kryesore të konventës, e cila kërkon që të respektohet si një garanci për përfshirjen e tyre në jetën publike lokale²⁵. Në nenin 3 të kësaj konvente kërkohet që banorëve të huaj t'u ofrohen të njëjtat kushte si shtetasve të saj duke i krijuar lirinë e të shprehurit, lirinë për të dhënë mendime si dhe lirinë për të marrë dhe transformuar ide dhe informacion pa njohur limite dhe pa ndërhyrje të autoriteteve publike. Pra, ashtu si edhe në akte të tjera ndërkombëtare, e drejta e informacionit parashikohet si një e drejtë e rëndësishme e dyanshme e cila sanksionohet me anë të kësaj marrëveshje ndërkombëtare. Po ashtu marrjen e informacionit dhe grumbullimin e ideve të banorëve të huaj mbi procese të konsultimit mbi çështjet lokale²⁶, konventa e ka parashikuar edhe me forma dhe mënyra të tjera, të tilla si nëpërmjet pyetsorëve, njoftimit të procedurave të planifikimit si dhe njoftimit.

²⁴ **Konventa për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal** është një traktat i Këshillit të Evropës, e cila u miratua në vitin 1992 dhe hyri në fuqi në vitin 1997. Ajo i jep të huajve të drejtën e votës në zgjedhjet lokale, me kusht që ata të plotësojnë të njëjtat kërkesa ligjore që zbatohen për shtetasit si dhe kenë qenë rezident të ligjshëm dhe të përhershëm në shtetin në fjalë për 5 vitet e mëparshme deri në zgjedhje.

²⁵ Shih: neni 8, Konventa për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal,

²⁶ *Shih*: neni 4, Konventa për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal,



4 Legjislacioni shqiptar mbi të drejtën e informimit

Legjislacioni shqiptar në lidhje me të drejtën e informimit, rezulton se reflekton në një masë të konsiderueshme standartet ndërkombëtare për ushtrimin e kësaj të drejte pa patur pengesa ligjore. Shqipëria ka kaluar nga një sistem autoritar ku veprimtaria ekzekutive ishte e mbyllur deri në kufijt e asaj që quhet hermetike, drejt një qeverisje të hapur ku çdo qytetar mund të informohet brenda një afati të arsyeshëm mbi aktivitetin e saj. Përmirësimet e vazhdueshme ligjore i kanë dhënë të drejtës për informim një garanci më tepër për ushtrimin e te drejtës dhe nga ana tjetër kanë ndikuar drejtpërdrejtë në transparencën e organeve publike. Më poshtë do të trajtojmë kuadrin ligjor se ku garantohet e drejta për informim në Shqipëri:

4.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë²⁷

Duke konsideruar Kushtetutën si “**ligjin themelor të një shteti, por edhe si një marrëveshje mes qytetarëve dhe pushtetarëve**”, informimi përbën një element kryesor që duhet sanksionuar në këtë “marrëveshje”²⁸. Në Republikën e Shqipërisë, Kushtetuta si ligji më i lartë i shtetit e cila shpreh vullnetin e popullit për të ndërtuar shtetin e së drejtës, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në mënyrë të qartë ka garantuar të drejtën e informimit²⁹. Kjo e drejtë kushtetuese e cila përfshihet tek të drejtat dhe liritë themelore të njeriut ushtrohet pa dallim për të gjithë shtetasit të cilët banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Si subjekte të kësaj të drejte përfshihen edhe personat juridik.

²⁷ **Kushtetuta e Shqipërisë** u miratua me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor dhe u aprovua më **22 nëntor 1998** përmes referendumit mbarëpopullor dhe u shpall me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Rexhep Mejdani, ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007, ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008, ndryshuar me ligjin nr. 88/2012, datë 18.09.2012

²⁸ *Shih*: Omari L. & Anastasi A., 2010 “E drejta kushtetuese”, Tiranë: Botimet ABC, fq. 23.

²⁹ *Shih*: neni 23, **Kushtetuta e Shqipërisë**,



E drejta për informim garantohet si një parim i përgjithshëm në pikën 1, të nenit 23 të Kushtetutës ku nuk përcaktohet ndonjë kufizim në subjektet e kësaj të drejte dhe nënkuptohet si një e drejtë negative që ushtrohet pa u cënuar nga autoritetet publike. Por, Kushtetuta në pikën 2, të nenit 23, ka parashikuar se:

"Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore."

Pra, konstatohet fakti se përcaktimi i modaliteteve dhe mënyrave për ushtrimin e të drejtës për të kërkuar informacion zyrtar, bëhet me ligj. Ndërsa sanksionimin e parimit për një qeverisje të hapur dhe transparente, e gjejmë në mënyrë indirekte në paragrafin e tretë të nenit 23 të Kushtetutës. Në këtë paragraf sanksionohet e drejta e kujt do për të ndjekur mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive. Parimi i transparencës në punën e organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive është një element i rëndësishëm i cili ndonëse nënkuptohet në këtë paragraf kushtetues, del më i qartë duke u gërshetuar edhe me dispozita të tjera Kushtetuese. Po ashtu në kuadër të këtij parimi të rëndësishëm kushtetues për një qeverisje transparente dhe të përgjegjshme, të dhënat mbi financat publike qoftë në nivel qendror apo lokale duhet të jenë të hapura për publikun³⁰.

Së bashku me të drejtat e tjera, Kushtetuta ka parashikuar edhe garancitë e duhura se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të

³⁰ Shih: pikën 4, neni 157, Po aty



të gjithë rendit juridik³¹. Prandaj në përmbushje të kësaj të drejtë, Kushtetuta ka ngarkuar organet e pushtetit publik me detyrimin për t'i respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre³². Për këtë arsye, është detyrim kushtetues që veprimtaria e këtyre organeve të jetë e hapur duke i krijuar kujtdo mundësinë për të ndjekur punën dhe veprimtarinë e tyre.

Ndonëse Kushtetuta përcakton qartë statusin e pacënueshëm të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në nenin 17 të saj është krijuar mundësia e kufizimeve të këtyre të drejtave dhe lirive. Këto kufizime mund të bëhen vetëm me ligj dhe për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve por asnjëherë nuk duhet të cënojnë thelbin e lirive dhe të drejtave. Në asnjë rast ato nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në nenin 22 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Duke garantuar lirinë e shprehjes, Kushtetuta ka ndaluar censurën ndaj mjeteve të komunikimit, duke krijuar në këtë mënyrë të gjitha kushtet për shkëmbimin e ndërsjellët të informacionit. Po ashtu Kushtetuta i ka kushtuar një rëndësi specifike edhe të drejtës së informimit në lidhje me dy çështje shumë të rëndësishme publike, të cilat janë ambienti dhe financat publike.

Informacioni në lidhje me çështje mjedisore përbën një ndër parimet më kryesore që qytetarët kanë të drejtë të informohen, prandaj edhe kjo e drejtë është sanksionuar si një e drejtë kushtetuese³³.

³¹ Shih, neni 15, **Kushtetuta e Shqipërisë**,

³² Shih: pika 2, neni 15, Po aty

³³ Shih: neni 56, Po aty



4.2 Ligji për Vetëqeverisjen Vendore³⁴

Një nga ligjet më të rëndësishme që rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat dhe të drejtat e tyre është ligji **“Për Vetëqeverisjen Vendore”** i cili ka hyrë në fuqi më 29 Janar 2016.



Në këtë ligj një kapitull i veçantë i është kushtuar **transparencës, konsultimit dhe pjesmarrjes qytetare**³⁵. Si një e drejtë kushtetuese, e drejta për informim e qytetarëve në nivel lokal përcaktohet qartësisht në dispozitat e këtij ligji duke siguruar në këtë mënyrë transparencën në punën e organeve të qeverisjes vendore dhe mundësinë për publikun për të marrë pjesë aktive në qeverisje. Në nenin 17 ligji ka parashikuar edhe modalitetet e njoftimit për mbledhjen e këshillit, i cili duhet të përmbajë datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes dhe të bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media duke përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, se:

“Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit”

Mënyra sesi zhvillohet procesi i pjesmarrjes së publikut në mbledhjet e këshillit komunal ose bashkiak përcaktohet në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e ndryshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare, ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore. Përveç kësaj një tjetër aspekt mjaft pozitiv i ligjit i cili zgjeron hapsirën e

³⁴ Ligji Nr. 139/2015, **“Për Vetëqeverisjen Vendore”**, miratuar me datë 17.12.2015, publikuar në Fletore Zyrtare Nr.249, datë 14.01.2016, Faqe:16963, i cili ka hyrë në fuqi më 29 Janar 2016

³⁵ Shih: Kapitullin IV, Ligji Nr. 139/2015, **“Për Vetëqeverisjen Vendore”**



pjesëmarrjes së qytetarëve është edhe e drejta e iniciativës qytetare³⁶. **Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.** Pra, në këtë mënyrë edhe nëpërmjet këtij ligji është sanksionuar **parimi i qeverisjes së hapur**, ku qytetarët janë të lirë të vëzhgojnë procesin vendimmarrës të qeverisjes lokale duke ndjekur nga afër mbledhjet e tyre.

Por ligji parashikon edhe kufizime, duke lejuar mundësinë që mbledhjet mund të bëhen të mbyllura me kërkesën e kryetarit të bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij. Në mënyrë të drejtpërdrejtë **e drejta e publikut për informim dhe parimi i transparencës**, sanksionohen në pikën 1

dhe 2 të nenit 15 të ligjit, ku përcaktohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.

2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike”

Po ashtu në pikën 3, të nenit 15, në ligj është përcaktuar se:

“Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit”

Pra, garantimi i publikut mbi transparencën e njësisve të qeverisjes vendore bëhet i mundur nëpërmjet sigurimit të një aksesit sa më të gjerë për të gjithë komunitetin për tu njohur me veprimtarinë e pushtetit lokal.

Në pikën 1 të nenit 16, ligji për vetëqeverisjen vendore, ka përcaktuar se:

“Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes”

³⁶ Shih: neni 20 i ligjit Nr. 139/2015, “**Për Vetëqeverisjen Vendore**”



Ligji ka sanksionuar edhe **parimin e qeverisjes me pjesmarrje**, ku në mënyrë të drejtpërdrejtë është parashikuar detyrimi i këshillave bashkiak që përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve të zhvillojë seanca këshillimi me komunitetin, duke përcaktuar rastet në të cilat ky këshillim është i detyrueshëm. Në mënyrë taksative ligji ka përcaktuar aktet të cilat duhet të konsultohen me publikun të cilat janë kur³⁷:

a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;

dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësisve e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;

e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;

f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;

k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;

Po ashtu në ligj është përcaktuar se njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të caktojnë **koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik**, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik. Këshillimi me publikun, në çdo rast, duhet të bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse ose **nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore**. Pra ligji ka parashikuar edhe referendumin vendore si një formë gjithpërfshirëse për këshillimin me publikun. Për ti dhënë një kuptim më të plotë dhe për të informuar sa më mirë qytetarët ligji ka përcaktuar se³⁸:

³⁷ Shih: Nenin 18, Ligji Nr. 139/2015, "**Për Vetëqeverisjen Vendore**"

³⁸ Shih: piken 3, neni 18 i ligjit Nr. 139/2015, "**Për Vetëqeverisjen Vendore**"



“Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim”

Sipas këtij neni, e drejta e informimit realizohet në mënyrë pasive si detyrim ligjor për ta afishuar në vende publike i vetë organit që nxjerr aktin dhe në mënyrë aktive sipas kërkesave të subjekteve ligjore, bazuar në të drejtën e tyre për informim. Pra në rastin e dytë, janë vetë qytetarët që kanë të drejtë të kërkojnë informacion përmes një kërkesë e cila depozitohet pranë organit i cili ka informacionin e kërkuar.

Në veprimtarinë e këshillit të qarkut, ligjvënësi ka ruajtur të njëjtin standart si për këshillin bashkiak, kur parashikon se ai zhvillon mbledhje të hapura për publikun, zhvillon seanca këshillimi me organet përfaqësuese dhe ekzekutive të bashkive, komunitetet përkatëse si dhe respekton të drejtën e publikut për t'u informuar.



4.3 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë³⁹

**KODI I PROCEDURAVE
ADMINISTRATIVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Ky ligj kufizohet kryesisht tek subjektet të cilat janë palë në një proces administrativ dhe të cilave u njihet e

drejta për informim, duke i bërë asaj një rregullim specifik. Me veprimtari administrative sipas ligjit duhet kuptuar:

“tërësia e akteve dhe veprimeve, që përbëjnë dhe shprehin vullnetin e administratës publike, si dhe ekzekutimin e vullnetit.”⁴⁰

Parimi i transparencës i sanksionuar në nenin 5 të Kodit të Procedurave Administrative i detyron organet publike që të bashkëpunojnë ngushtë me persona fizike dhe juridike. Po ashtu në Kodin e ri të Procedurave Administrative në nenin 6 të tij sanksionohet parimi i informimit ku theksohet se:

“Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit”

Për herë të parë në Kodin e Procedurave Administrative është përcaktuar mënyra e funksionimit të zyrave me një ndalesë si një detyrim ligjorë për ofrimin e shërbimeve sa më afër qytetarit dhe për të garantuar informimin e veprimtarisë së administratës publike dhe të procedurave administrative në shërbim të një qeverisje sa më transparente⁴¹.

³⁹ Ligji nr.44, i miratuar më datë 28.05.2015, “Kodi i Procedurave Administrative” hyri në fuqi më datë 28 Maj 2016 duke shfuqizuar Ligjin Nr.8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”

⁴⁰ Shih: pika 12, neni 3, i ligjit nr.44, datë 28.05.2015, “Kodi i Procedurave Administrative”

⁴¹ Shih: pika 12, neni 3, i ligjit nr.44, datë 28.05.2015, “Kodi i Procedurave Administrative”



4.4 Ligji “Për të drejtën e informimit”⁴²

Një nga ligjet më kryesore ku sanksionohet e drejta e informimit në lidhje me aktivitetin e autoriteteve publike në Republikën e Shqipërisë është ligji Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, miratuar më 18.09.2014. Me miratimin e këtij ligji është shfuqizuar ligji i mëparshëm Nr.8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për Dokumentet Zyrtare”, i cili rregullonte të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare. Ligji i ri ka sjell disa risi në krahasim me ligjin e mëparshëm. Ky ligj e ka zgjeruar objektin e tij duke i dhënë më tepër mundësi publikut të ushtroj të drejtën e informimit në praktikë si dhe të formimit të pikpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë.



Në nenin 3 të këtij ligji është përcaktuar se:

“Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.”

⁴² Ligji Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, miratuar më 18.09.2014, publikuar në Fletore Zyrtare Nr.160, datë 17 Tetor 2014, Faqe:8169



Një ndër qëllimet e këtij ligji është nxitja e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.⁴³ Prandaj ligji i ri në krahasim me atë të mëparshmin, ka përfshirë disa detajime të mëtejshme në funksion të përmirësimit të ushtrimit të së drejtës së informimit duke përfshirë edhe disa koncepte të reja.

Nga krahasimi i dy ligjeve rezulton se është zgjeruar koncepti i **“autoritetit publik”**, duke përfshirë edhe persona fizikë apo juridikë të cilët ligji i ka ngarkuar me ushtrimin e funksioneve publike si dhe shoqëritë tregtare ku shteti zotëron shumicën e aksioneve⁴⁴. Subjekte të këtij ligji janë autoritete publike ku përfshihen:

1. *Te gjitha organet administrative të parashikuara në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative duke përfshirë:*
 - a) *organet ligjvënëse,*
 - b) *organet gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli,*
 - c) *organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli,*
 - d) *organet shtetërore*
 - e) *entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj;*
 - f) *shoqëritë tregtare ku shteti zotëron shumicën e aksioneve;*
 - g) *çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.*

Në nenin 2, pika 5 e ligjit jepet përkufizimi i asaj që ligji e quan si **“Programe transparence”**, duke nënkuptuar tërësinë e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik. Ligji i ka ngarkuar autoriteteve publike që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij të hartojnë programe institucionale të transparencës, të cilat garantojnë njohje maksimale të informacionit publik me tendencën për t’i bërë ato sa më tepër publike. Këto programe duhet të përcaktojnë kategoritë e informacionit që bëhen

⁴³ Shih: neni 1, ligji Nr. 119/2014, datë 18.09.2014, **“Për të drejtën e informimit”**,

⁴⁴ Po aty: neni 2, pika 1



publike pa kërkesë dhe mënyrën e bërjes publike të këtij informacioni⁴⁵.

Po ashtu për herë të parë në ligj përfshihet edhe figura e **“Kordinatorit për të drejtën e informimit”**. Kordinatori është një nëpunës civil i cili ka si detyrë të bashkërendoj punën për garantimin e së drejtës së informimit⁴⁶. Sipas nenit 2, pika 2 e ligjit përcaktohet si **“informacion publik”** çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Për herë të parë ligji ka parashikuar edhe krijimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve⁴⁷. Ky regjistër është një instrument matës i punës që ushtrojnë autoritetet publike në funksion të zbatimit të së drejtës për informim. Në funksion të përbushjes së qëllimit të ligjit për të rritur transparencën ndaj publikut, regjistri është i detyrueshëm të vendoset në mjediset e pritjes së publikut, në zyrat e autoritetit publik si dhe të publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik duke e përditësuar atë çdo 3 muaj. Po ashtu ligji ka përcaktuar edhe modalitete dhe afate të arsyeshme për marrjen e informacionit si dhe rastet kur ai është i detyrueshëm të tërhiqet sipas një procedure të caktuar. Në ndryshim me ligjin e mëparshëm, ku afati për të dhënë informacion sipas kërkesës ishte 40 ditë, me ligjin e ri është bërë 10 ditë⁴⁸. Sipas këtij ligji, janë parashikuar edhe rastet kur marrja e informacionit mund të ketë një tarifë të caktuar e cila do të përcaktohet në bazë të kriterëve dhe vendimeve të organit publik. Si rregull janë pa pagesë të gjitha kërkesat për informacion. Ky informacion do të jepet nëpërmjet konsultimit të tij në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo kur është rasti nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit

⁴⁵ Po aty: neni 4, pika 1

⁴⁶ Po aty: neni 10

⁴⁷ Shih neni 8, ligji Nr. 119/2014, datë 18.09.2014, **“Për të drejtën e informimit”**,

⁴⁸ Po aty: shih neni pika 1, neni 15



publik në internet⁴⁹. Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë përshkruhen në mënyrë të detajuar në nenin 7 të ligjit “**Për të drejtën e informimit**” të cilat janë:

- a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;
- b) tekstet e plota:
 - i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;
 - ii) të ligjeve;
 - iii) të akteve nënligjore;
 - iv) të kodeve të sjelljes;
 - v) të çdo dokumenti politikash;
 - vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;
- c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planin strategjik të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë:
 - i) listën e kontratave të lidhura;
 - ii) shumën e kontraktuar;
 - iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;

⁴⁹ Po aty: shih neni 14



- iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;*
- f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;*
- g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;*
- gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;*
- h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;*
- i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;*
- j) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;*
- k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;*
- l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.*

Ligji i ngarkon Autoritetet publike, gjithashtu me detyrimin, për të krijuar dhe arkivuar një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Po ashtu aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta duhet të bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga autoritetet publike.

Ashtu siç edhe parashikohet edhe nga aktet ndërkombëtare të përshkuara në këtë kapitull edhe ky ligj ka parashikuar rastet për të cilat e drejta për informim mund të kufizohet. Në ligjin e mëparshëm, kufizimi i të drejtës së informacionit ishte parashikuar vetëm në ato raste kur ajo parashikohej me ligj, ndërsa në ligjin e ri është përcaktuar se kufizimi mund të ndodhë në rastet kur është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton



interesa të caktuara të cilat janë përcaktuar sipas ligjit në mënyrë të detajuar dhe të saktë⁵⁰.

Në nenin 18, ligji parashikon sanksione të ashpra për mosrespektimin e dispozitave të tij nga veprimet dhe mosveprimet e kryera në kundërshtim me ligjin. Në këto raste kemi të bëjmë me kundërvajtje administrative të cilat dënohen me gjobë.

Si përfundim duhet theksuar se ligji i ri në krahasim me ligjin e mëparshëm është më i plotë, më i zgjeruar dhe ajo çfarë është më e rëndësishme rrit përgjegjshmërinë e administratës publike ndaj zbatimit të së drejtës për informim, duke përfshirë masa të rënda ndëshkuese për çdo shkelje të konstatuar.

4.5 Ligji “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”⁵¹



Parlamenti Shqiptar më **30 Tetor 2014**, ka miratuar një ligj mjaft të rëndësishëm “**Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik**” i cili synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike. Ky ligj i cili zbatohet për rregullat dhe procedurat e njoftimit e të konsultimit publik të cilat duhet që të zhvillohen nga organet publike në proceset politikbërëse dhe vendimarrëse ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen e pjesmarrjes së publikut në qeverisje. Duke përcaktuar rregullat procedurale që duhen zbatuar, garantohet pjesmarrja e publikut në proceset politikbërëse dhe vendimarrëse të cilat zhvillohen dhe udhëhiqen nga organet publike. Një nga objektivat e këtij ligji është rregullimi i procesit të njoftimit dhe të konsultimit publik të projekt-dokumenteve strategjik kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të

⁵⁰ Po aty: shih neni 17, ligji Nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “**Për të drejtën e informimit**”,

⁵¹ Ligji Nr. 146/2014, “**Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik**”, miratuar më 30/10/2014 publikuar në fletore zyrtare nr 178 datë 24 Nëntorë 2014, faqe 9189



lartë publik⁵². Në këtë ligj janë përfshirë edhe organet publike të pushtetit vendor të cilat kryejnë funksione administrative duke bazuar punën e tyre sipas disa parimeve të rëndësishme të cilat janë⁵³:

- a) **transparenca** gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik me pjesmarrje gjithpërfshirëse dhe jodiskriminuese;
- b) **efektshmëria** e procesit të vendimmarrjes në organet publike;
- c) **përgjegjësia** e organeve publike ndaj palëve të interesuara.

Procesi i konsultimit, të cilit për herë të parë i është bërë një rregullim i veçantë ligjor, mund të konsiderohet *si një proces i institucionalizuar i shkëmbimit të informacionit*. Por ligji “Konsultimin publik” e ka përkufizuar si:

“tërheqja e mendimeve dhe sygjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projekt-aktit, nga momenti i publikimit të projekt-aktit deri në miratimin përfundimtar të tij.”⁵⁴

Prandaj, për të garantuar një proces konsultimi publik sa më gjithpërfshirës dhe për të garantuar pjesmarrjen e publikut në qeverisje, ligji detyron organet e autoritetit publik të kryejnë një proces sa më transparent. Ato duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të informuar nëpërmjet publikimeve në regjistrin elektronik të projekt-aktit, si dhe në programin e transparencës, të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes. Ato duhet të informojnë në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit e deri te miratimi i aktit përfundimtar. Gjatë këtij procesi, ato duhet të ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për të krijuar mundësinë efektive të kontributit, për të gjitha palët e interesuara. Në nenin 8 të këtij ligji, ku përcaktohen se kush mund të jenë palët e interesuara, bie në sy

⁵² Shih: pika 1, neni 1, Ligji Nr. 146/2014, datë 30/10/2014, “**Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik**”,

⁵³ Po aty, neni 5

⁵⁴ Po aty neni 2, pika 5



fakti që ligji ja njeh këtë të drejtë edhe grupeve të interesit, por duke mos u shprehur nëse këto grupe mund të jenë me personalitet juridik apo thjesht grupe informale që përfaqësojnë një interes të caktuar. Ligji është shprehur në mënyrë më eksplicite në përcaktimin e personave të huaj, duke i njohur si palë qoftë ato fizikë dhe juridikë.

Natyrshëm që një nga të drejtat kryesore që palët kanë në përcaktimet e këtij ligji, është e drejta e informimit. Në ushtrimin e kësaj të drejte ato mund të njihen me projekt-aktin si dhe mund të propozojnë fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e projekt-akteve apo të bëjnë komente dhe të adresojnë rekomandime⁵⁵.

Por si gjithmonë çdo e drejtë ka edhe kufijtë e saj, prandaj edhe në këtë ligj parashikohen kufizime të caktuara. Në ligj është parashikuar se pjesmarrja e publikut mund të kufizohet kryesisht në ato raste të cilat lidhen me sigurinë kombëtare.

Një nga risitë e këtij ligji është edhe fakti se sanksionohet dhënia e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, ku përfshihet:

- a) publikimi i projekt-aktit,*
- b) marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij,*
- c) organizimi i debateve publike,*
- d) miratimi i aktit përfundimtar.*

Po ashtu një tjetër element që përfshihet në këtë ligj është edhe krijimi i regjistrit elektronik. Çdo projekt-akt duhet të publikohet në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik. Nëpërmjet këtij regjistri sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit e të gjitha palëve të interesuara me organin publik. Ky regjistër do të shërbej si një pikë qendrore konsultimi. Kjo

⁵⁵ Shih: neni 9, Ligji Nr. 146/2014, date 30/10/2014, "**Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik**"



formë siguron dhe forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbim, duke pasur në vëmendje dhe nevojat specifike për persona apo grupime të caktuara.

Një tjetër element i rëndësishëm i parashikuar në këtë ligj është edhe organizimi i takimeve publike, në rastet kur kemi të bëjmë me takime të rëndësishme. Ligji ka parashikuar mënyrat e njoftimit, ndër të cilat përfshihen komunikimet elektronike, mediat e shkruara dhe audiovizive, etj.⁵⁶ Ligji ka ngarkuar organin publik që të grumbulloj të gjitha sygjerimet e pjesmarrësve gjatë këtyre takimeve, dhe së bashku me sygjerimet e refuzuara t'i njoftoj sipas mënyrave të përcaktuara në këtë ligj. Në fund të çdo viti është e detyrueshme që të përpilohen raporte ku të prezantohen të dhëna në lidhje me aktet e miratura, sygjerimet e pranuar dhe ato të refuzuara. Shqyrtimi i ankesave në lidhje me respektimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj bëhet nga drejtuesi i autoritetit publik dhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda një afati 30 ditor⁵⁷.

⁵⁶ Shih neni 11, Ligji Nr. 146/2014, datë 30/10/2014, "**Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik**",

⁵⁷ Shih: Po aty neni 21 i ligjit



5.Përfundime:

Legjislacioni shqiptar në lidhje me të drejtën për informim, rezulton të jetë përgjithësisht i plotë dhe sipas standarteve ndërkombëtare. Nga përshkrimi analitik rezultojnë një numër aktesh ndërkombëtare që Shqipëria ka aderuar të cilat sannksionojnë të drejtën për informim. Po ashtu edhe kuadri ligjor me ndryshimet e viteve të fundit, i kanë dhënë të drejtës për informim një dimension të ri. Qytetarët tashmë kanë më tepër mundësi, kanë më tepër njohuri dhe duke qenë të informuar sigurisht ato do të jenë më pranë qeverisjes duke ushtruar në mënyrë efektive të drejtën e tyre të pjesmarrjes në qeverisje.

Duke qenë ligj i ri, i cili fut një marëdhënie të re ndërmjet qytetarëve dhe qeverisë në të gjitha nivelet, do ndalemi më gjatë në komentin tonë tek ligji *“Për njoftimin dhe konsultimin publik”*. Ky ligj përbën një arritje të re ligjore në drejtim të hapjes së qeverisjes dhe ngushtimit të hendekut të saj me qytetarët. Kjo përbën një tendencë serioze për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, duke zgjeruar hapsirën ligjore ku ato kanë mundësinë të shprehin alternativat e tyre dhe shqetësimet të cilat lidhen me vendimin që pritet të merret. Por sigurisht, ligji ka nevojë që të testohet në praktikë duke qenë se është ende herët për të bërë vlerësime në lidhje me problematikat gjatë aplikimit të tij. Gjithsesi ekzistojnë gjithmonë hapsirat e nevojshme, nisur nga eksperiencat e mëparshme, për të shprehur disa komente dhe vlerësime kritike në drejtim të rritjes së efektivitetit të pjesmarrjes:

1) Një ndër pikat kryesore, që ky ligj nuk shprehet qartë, mbetet garancia e pjesmarrjes së publikut në qeverisje. Vërtet që janë parashikuar mënyrat e njoftimit, por shpesh ato nuk rezultojnë efikase dhe takimet përfundojnë të jenë formale dhe nuk sjellin rezultatet e pritshme. Nuk është e qartë sesi do të bëhet komunikimi elektronik, duke qenë se jo të gjithë



qytetarët e kanë mundësinë e përdorimit të mjeteve elektronike. Në këtë rast, rezulton si domosdoshmëri ngritja e një database ku të gjithë të interesuarit, qytetarë apo grupe interesi mund të regjistrohen dhe të komunikojnë në mënyrë elektronike. Por përsëri në kushtet kur komunikimi elektronik nuk ka një rregullim të qartë ligjor edhe kjo formë mbart shumë pikpyetje. Një pikë tjetër ku ligji duhet të shprehet në mënyrë më të qartë është kur bëhet fjalë për çështje të rëndësishme. Takimet e hapura publike duhet të theksohet që prania e mediave duhet të jetë e detyrueshme, duke i dhënë atyre mundësinë e transmetimeve të drejtpërdrejta pa cungime dhe censura të çfarëdo lloji.

2) Po ashtu, ligji ka parashikuar si autoritetin e shqyrtimit të ankesave në rastet e moszbatimit të këtij ligji titullarin e autoritetit publik dhe Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Por besoj që kjo nuk është e mjaftueshme. Në rastin e ankesave në nivel lokal, kjo zvogëlon mundësinë e ushtrimit të kësaj të drejte e sidomos kur bëhet fjalë për ato ankesa drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ligji duhej që të kishte parashikuar në mënyrë eksplicite edhe rrugën gjyqësore si një mënyrë efektive ankimi, ashtu siç është parashikuar në ligjin Nr. 119/2014 **“Për të drejtën e informimit”**,

Po ashtu duke qenë se ligji i njeh të drejtën autoriteteve lokale për të ngritur struktura në ushtrim të funksioneve të veta⁵⁸, një mënyrë efikase dhe më e besueshme për shqyrtimin e këtyre ankesave mund të ishin strukturat administrative (këshillat apo dhomat administrative), të cilat i kemi trajtuar në mënyrë më të detajuar në kapitullin për të drejtën e pjesmarrjes në drejtësi.

3) Mënyra e shqyrtimit të sygjërimeve dhe sidomos i njoftimit të rasteve, kur kemi të bëjmë me refuzimin e këtyre sygjërimeve nuk është shumë efikase dhe tendenca do të jetë drejtë një procesi formal. Për ta bërë sa

⁵⁸ Shih gërma d, neni 9 të ligjit Nr. 139/2015, **“Për Vetëqeverisjen Vendore”**



më efektive, ligji duhet që të detyroj organin publik që të zhvilloj një takim të dytë me palët e interesuara ku të diskutohen dhe të jepen argumenta në lidhje me arsyet e refuzimit të këtyre sygjërimeve. Një praktikë e tillë mund të sjellë dy skenarë të pritshëm të cilët janë:

- a) Palët bien dakort me argumentat, ku ose organi publik mund të bindet dhe pranon sygjërimet që t'i përfshij në akt ose publiku pranon që t'i tërheq këto sygjërime*
- b) Palët nuk bien dakort dhe nuk tërhiqen nga pozicionet fillestare*

Problemi më i vështirë për zgjidhje qëndron në pikën b). Kjo përbën një problem më vehte duke qenë se zgjidhja e këtij rasti demonstron vërtet modelin e një qeverisje demokratike e cila mbështetet tek qytetarët e saj. Prandaj në një rast të tillë ka shumë rëndësi të kuptohet arsyeja e sygjërimeve të refuzuara, në çfarë argumentash ligjor mbështetet, në çfarë mase qytetarët i mbështetin këto sygjërime. Në rastin kur sygjërimet kanë një bazë të mirë ligjore atëherë është e kuptueshme që edhe nëse sygjërimi nuk do pranohet atëherë gjykata mund të vendos përfshirjen e tyre, por edhe në këtë rast ligji nuk e ka parashikuar ankimin gjyqësor, prandaj kjo është një mangësi e këtij ligji në drejtim të përfshirjes së qytetarëve.

Në rastin tjetër, i përket organit vendimarrës të kuptoj se këto sygjërime gjejnë mbështetje tek masa e qytetarëve që preken nga kjo vendimmarrje. Prandaj në këtë rast organi publik lokal, në varësi të rëndësisë së vendimmarrjes së aktit të cilin po trajton, mund t'i ofrohen tre alternativa në mënyrë që procesi të jetë sa më transparent dhe sa më gjithpërfshirës:

- a) Të organizojë takime më të zgjeruara me publikun për të marrë mbështetje sa më të gjerë.*
- b) T'ja kalojë organit që është zgjedhur drejtpërdrejtë nga komuniteti lokal⁵⁹ për një vendim përfundimtar.*

⁵⁹ Këshilli bashkiak ose Kryetarit i njësisë së qeverisjes vendore



Së fundi ligji nuk ka përcaktuar në një mënyrë të gjerë palët e interesuara. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar se edhe personat juridik janë bartës së të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në Kushtetutë⁶⁰. Në frymën e këtij interpretimi kushtetues përfshirja dhe përcaktimi në mënyrë ekskluzive edhe i personave juridikë si palë e interesuar është domosdoshmëri kushtetuese.

⁶⁰ Shih: pika 2, neni 16 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë



6.Rekomandime

Nga analiza e permbledhur ligjore rezultojnë se publikut i garantohet e drejta e informacionit. Nëpërmjet ushtrimit të kësaj të drejte qytetarëve u mundësohet pjesmarrja në takimet në nivel komunitar, prandaj edhe legjislativi aktual i ka kushtuar rëndësi mënyrës dhe formës së njoftimeve për veprimtarinë e administratës publike. Rezultojnë se efektiviteti i pjesmarrjes publike lidhet drejtpërdrejtë me informacionin që i jepet publikut. Por në disa raste, ka probleme dhe mangësi në zbatimin e të drejtës për informim. Kjo ka sjell edhe mungesën dhe pasivitetin e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Ndonëse kuadri ligjor në lidhje me të drejtën e informimit rezultojnë i plotë, si në shumicën e ligjeve tjera problemet më të shumta ndeshen në zbatimin e ligjit. Ligji i ri ka parashikuar shkurtimin e afateve për të dhënë përgjigje ndaj kërkesave për informacion dhe po ashtu ka parashikuar penalitete të ashpra ndaj të gjithë atyre titullarëve dhe përgjegjësve të cilët nuk e respektojnë ushtrimin e kësaj të drejte nga qytetarët. Ndonëse vihen re neglizhenca për dhënien e informacionit ndaj qytetarëve, administrata publike ka ndjeshmëri më të lartë për të shërbyer në kohë në lidhje me kërkesat që vijnë nga përfaqësues të mediave, organizatave të shoqërisë civile apo institucioneve të tjera. Ndryshime në ligjin për të drejtën për informim pritet që të ndikojnë drejtpërdrejtë edhe në pjesmarrjen e qytetarëve në qeverisje. Gjithsesi, ajo se çfarë vlen që të përmirësohet dhe u rekomandohet autoriteteve publike, është:



- 1) *Hartimi i programeve informuese në lidhje me të drejtën e informimit që kanë qytetarët. Këto programe duhet që të japin një informacion praktik mbi ligjin për të drejtën e informimit, duke shpjeguar në forma praktike sesi qytetarët mund ta ushtrojnë këtë të drejtë.*
- 2) *Të mbështesin organizata të shoqërisë civile në fushata ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi në lidhje me të drejtën e qytetarëve për informim, me qëllim për të zgjeruar dhe përhapur informacionin në grupe të ndryshme qytetare.*
- 3) *Ngritja e kapaciteteve të administratës së njësisive të qeverisjes vendore për të zbatuar me rigorozitet detyrimet ligjore në kuadër të ushtrimit të së drejtës për informim.*
- 4) *Ngritja e strukturave monitoruese të përbashkëta me përfaqësues të komunitetit për të monitoruar ushtrimin e kësaj të drejte dhe detyrimeve ligjore.*
- 5) *Zhvillimi i platformave të teknologjisë online për shkëmbimin e informacionit.*
- 6) *Zhvillimi i partneriteteve të institucionalizuara me organet e mediave për të bërë të mundur promovimin e të drejtës për informim si dhe prezantimin në mënyrë sa më objektive të aktiviteteve të pushtetit lokal.*



7.Lexime te metejshme:

Bibliografia

1. Çela, Erisa & Ismaili, Valmir & Hafner, Tanja. 2008. *“Praktikat e mira rajonale mbi pjesmarrjen komunitare në qeverisjen vendore”*, Tiranë; Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
2. Chanan, Gabriel. 1997 *“Active Citizenship and Community Involvement”*, Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities
3. Dahl, A. Robert. 1956. *“A Preface to Democratic Theory”*, Chicago: University of Chicago Press.
4. Davidson, Scott. 1998. *“Spinning the Wheel of empowerment”*, Planning, vol.1262, fq. 14-15.
5. Dearlove, John. 1973. *“The Politics of Policy in Local Government”*, Cambridge: Cambridge University Press.
6. Dobjani.Ermir.2010 *“E drejta administrative 1”*, Tirane: Perlat Voshtina, fq 197
7. Dobjani E., Pollozhani B., Stavileci E., Salihu L. 2010 *“E drejta administrative aspekte krahasuese”*, Shkup: Asdreni, fq 143.
8. Guidi, G. *“La società dell’ informazione: libertà, pluralismo, risorse”*, Diritto Pubblico Comparato ed Europeo, Atti del convegno dell’Associazione di San Marine, 30 Settembre 2005, G.Giappichelli Editore, 2006, fq 2.
9. Ibrahim, Gent. *“Gjyqësori dhe e drejta e informimit”*, në Konferencën Kombëtare “E drejta e informimit e drejta themelore e njeriut”, Tiranë 2003, fq. 41.
10. IPPR. 2004. *“Lonely Citizens: Report of the Working Party on Active Citizenship”*. London:Institute for Public Policy Research.



11. Instituti Shqiptar i Medias.2012“***Monitorimi i aksesit ne institucione publike***”, Tirane:ISHM
12. Martines Temistocle. 2011. “*E drejta kushtetuese*”, Tiranë; UET Press.
13. Meidani, Rexhep. 2009. “*Mbi qeverisjen*”, Tiranë: Dudaj
14. Merloni, F. 2008 “*La trasparenza amministrativa*”, Milano: Giuffrè Editore, fq. 237
15. Ministria e Integritimit “*Version i konsoliduar i Traktatit te BE dhe Traktatit per funksionimin e BE dhe Karta e te Drejtave Themelore te BE*”, Tirane: Ministria e Integritimit, neni 11, fq 23-24
16. Monika Carss-Frisk.2003 “***Liria e shprehjes***”, Manualet e të drejtave të njeriut Nr 2, Një udhëzues për zbatimin e nenit 10 të KEDNJ, Botimi i dytë, Tiranë: Gent Grafik, fq. 13
17. Omari, Luan. 2007. “*Parime dhe institucione të së drejtës publike*”, Tiranë: Elena Gjika
18. Omari, Luan, 2008, “*Shteti i se drejtes*”, Tiranë: Elena Gjika.
19. Omari, Luan & Aurela Anstasi. 2010. “*E drejta kushtetuese*”, Tiranë: ABC, fq 23
20. Omari, Luan. 2011. “*Ndarja e pushteteve dhe pavaresia e institucioneve kushtetuese*”, Tiranë: Elena Gjika
21. Zakaria, Fareed. 2004. “*E ardhmja e lirisë*”, Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit



Referenca ligjore

1. Kuvendi i Shqipërisë.1991. *“Për ratifikimin e Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike”* Ligji nr.7510, datë 8 Gusht
2. Kuvendi i Shqipërisë.1996. *“Për ratifikimin e Konventës Evropiane Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”* Ligji nr.8137, datë 31 Korrik
3. Kuvendi i Shqipërisë.1998. *“Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”*; Ligji Nr.8417, datë 21 Tetor.
4. Kuvendi i Shqipërisë.1999. *“Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”* i shfuqizuar, Ligji nr.8503, datë 30 Qershor
5. Kuvendi i Shqipërisë.1999. *“Për ratifikimin e Kartës Evropiane për Autonominë Vendore”*; Ligji nr.8548, datë 11 Nëntor
6. Kuvendi i Shqipërisë.2000. *“Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit”* Ligji nr.8672, datë 26 Tetor
7. Kuvendi i Shqipërisë.2001. *“Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”* Ligji nr.9228, datë 29 Prill
8. Kuvendi i Shqipërisë.2005. *“Për ratifikimin e Konventës për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal”* Ligji nr.9364, datë 31 Mars
9. Kuvendi i Shqipërisë. 2014. *“Për të drejtën e informimit”*, Ligji nr.119, datë 18 Shtatorë
10. Kuvendi i Shqipërisë. 2014.*“Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”*, Ligji nr.146, datë 30 Tetor
11. Kuvendi i Shqipërisë. 2015.*“Kodi i Proçedurave Administrative”* Ligji nr.44, datë 28 Maj, ky ligj hyri në fuqi me datë 28 Maj 2016.
12. Kuvendi i Shqipërisë.2015. *“Për Vetëqeverisjen Vendore”* Ligji nr.139, datë 17 Dhjetore